REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

<table>
<tr><th>Nr. Rendor</th><th>Data e kërkesës</th><th>Objekti i kërkesës</th><th>Data e përgjigjes</th><th>Përgjigja</th><th>Mënyra e përfundimit të kërkesës</th><th>Tarifa</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>05.01.2026</td><td>Kërkesë me email-Gazetar

1. Planin e punës/planin e veprimit të institucionit tuaj (nëse ka) për zbatimin e masave ku jeni përgjegjës sipas Udhërrëfyesit të Strategjisë;
2. Nëse janë miratuar akte mbi masat për monitorimin e investimeve dhe kapitaleve të huaja, sektorët kritikë, furnitorët e pasigurt dhe raportimet periodike.</td><td>15.01.2026</td><td>(1) Lidhur me pyetjen 1: Planin e punës/planin e veprimit të institucionit tuaj (nëse ka) për zbatimin e masave ku jeni përgjegjës sipas Udhërrëfyesit të Strategjisë;

Në funksion të zbatimit të “Strategjisë kombëtare kundër ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit 2025–2030”, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) ka hartuar dhe miratuar planin e veprimit (të cilin e gjeni bashkëlidhur këtij e-maili), i cili bazohet në dy masat në vijim për të cilat AIF është përcaktuar si një nga institucionet përgjegjëse.
<table>
<tr><th>FUSHAT DHE OBJEKTIVAT</th><th>PËRSHKRIMI</th><th>AFATI KOHOR</th><th>INSTITUCIONI PËRGJEGJËS</th></tr>
<tr><td>3.1.1 Miratimi i ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja</td><td>Shqipërisë i nevojitet një ligj i ri që parashikon një Mekanizëm për Shqyrtimin e Investimeve (MSHI) dhe që përfshin përkufizime të qarta të: a) sigurisë kombëtare; b) infrastrukturës kritike (energjetika, transporti, uji, shëndetësia, komunikimet, media, përpunimi ose ruajtja e të dhënave, infrastruktura</td><td>Brenda 2026-s</td><td>Këshilli i Ministrave
Kuvendi i RSH-së
Struktura përgjegjëse
Ministria përgjegjëse për financat
Ministria përgjegjëse për ekonominë
BSH
AIF
AKSK
AKSHI</td></tr>
</table></td><td>Përfunduar/ dërguar përgjigje me email</td><td>Jo</td></tr>
</table>

						zgjedhore ose financiare, si dhe strukturat delikate dhe investimet në blerje toke dhe pasurie të paluajtshme që janë thelbësore për përdorimin e infrastrukturave në fjalë); c) teknologjitë kritike dhe objektet me përdorim të dyfishtë (duke përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën, gjysmëpërcjellësit, sigurinë kibernetike, kuantumin, hapësirën ajrore, mbrojtjen, ruajtjen e energjisë dhe teknologjitë bërthamore, nanoteknologjitë dhe bioteknologjitë); d) aksesin ose aftësinë për të kontrolluar informacionet delikate (përfshirë të dhënat personale) dhe; e) lirinë dhe pluralizmin e medias. Gjatë hartimit të legjislacionit për MSHI-në, të përfshihen grupet e interesit, si		KDIMDHP			

						komuniteti i biznesit.					
					3.2.1 Forcimi i ndërveprimit dhe i komunikimit të sektorit privat me institucionet publike	Zhvillimi i forumeve me pjesëmarrjen e aktorëve publikë dhe privatë për analizimin e dinamikave të tregut në raport me vulnerabilitetet e ekonomisë vendëse në raport me aktorët e huaj.	Periodik 12-mujor	BSH AMF **AIF** Struktura përgjegjëse Ministri përgjegjës për sipërmarrjen Këshilli Ekonomik Kombëtar Dhoma Kombëtare e Ekonomisë Organizata përfaqësuese të operatorëve ekonomikë			

(2) Lidhur me pyetjen 2: Nëse janë miratuar akte mbi masat për monitorimin e investimeve dhe kapitaleve të huaja, sektorët kritikë, furnitorët e pasigurt dhe raportimet periodike.

Gjatë muajit Dhjetor 2025 AIF ka dhënë kontributin në lidhje me projekt-vendimin për "*Miratimin e rregullores mbi procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte që lidhen me ose ndikojnë infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike, qasjen në informacion të ndjeshëm apo për lirinë e medias*", i cili përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në Republikën e Shqipërisë, që lidhen ose ndikojnë në infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me inpute kritike, aksesin në informacione të ndjeshme ose lirinë e medias dhe koordinimin me Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian. Projekt-vendimi është duke u draftuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

				Në vijim paraqitet një informacion i përmbledhur në lidhje me objektivin 3.2.1: *1. Lidhur me takimet e Grupit Ndërinstitucional i Punës (GTNP):* GTNP është ngritur në Dhjetor 2023[1] si një strukturë e posaçme në funksion të rritjes së efektivitetit të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përbëhet nga 38 anëtarë, ku 28 anëtarë janë përfaqësues të institucioneve publike dhe 10 anëtarëjanëpërfaqësues të sektorit privat. Në dhjetor të vitit 2024, GTNP ka miratuar Strategjinë "*Për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizimit në shoqërinë tonë 2025 – 2027*"[2]. Në këtë strategji, ndër të tjera janë përfshirë dhe risqet që lidhen me efektet e keqinformimit dhe roli i edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut në funksion të parandalimit që ai ka në fushën ekonomiko-financiare ka të bëjë në mënyrë më specifike me shpërndarjen e lajmeve të rreme apo informacioneve mashtruese, në lidhje me çështjet financiare, me qëllim të manipulimit të tregjeve, investitorëve ose sistemeve financiare për përfitime personale duke u bazuar në këshilla të rreme për investime, manipulimi i pasqyrave financiare, ose skemat mashtruese që synojnë individët apo institucionet. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për rreziqet që vijnë nga kjo veprimtari keqinformuese, synon që nëpërmet identifikimit të llojit të lajmeve dhe burimeve të tyre të vlerësojë dhe ndikimet përkatëse. Në vitin 2025, GTNP ka zhvilluar 6 takime, në të cilat në disa prej tyre është trajtuar edhe efekti që risqet PP/FT dhe ndërhyrjet e huaja kanë në sistemin ekonomiko-financiar të vendit. 2. *Lidhur me aktivitetet në kuadrin e zbatimit të strategjisë"Për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizimit në shoqërinë tonë 2025 – 2027":* Në këtë kontekst gjatë vitit 2025, janë zhvilluar një sërë takimesh informuese me:		

[1] Krijuar me vendimin nr. 2, datë 26.12.2023 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP)

[2] https://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Strategjia-per-edukim-e-publikut-per-rreziqet-e-PP-FT-2024-2027-Dhjetor-2024-1.pdf

				– Dhomën Kombëtare të Noterisë; – Shoqatën e Bankave të Shqipërisë; – Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; – Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), auditues dhe kontabilistë; – Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë; – Shoqatën Shqiptare e Këmbimit Valutor (AFEA); – Shoqatën e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme (NAREA); – Shoqatën Mikrofinanca Shqiptare; – Në bashkëpunim me shoqatën EMA dhe me komunitetin e biznesit, u zhvilluan 2 takime informuese, me përfaqësues të shoqërisë civile dhe lektorë. *të cilat ndër të tjera, këto 2 takime, kanë nxjerrë në pah dhe risqet që lidhen me keqinformimin.* Në datën 21.05.2025, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA) dhe me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (DHTIT) zhvilluan një tryezë diskutimi mbi "*Strategjinë e edukimit të publikut mbi rrezikun që mbart në shoqërinë tonë pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit 2025–2027*", në të cilën morën pjesë rreth 71 pjesëmarrës, duke u përqendruar në rolin që duhet të luajnë jo vetëm institucionet shtetërore, por edhe shoqëria civile, institucionet arsimore, media dhe sektori privat. U trajtua gjithashtu, që keqinformimi mund të cënojë funksionimin e tregjeve, të dëmtojë interesat e ligjshme të investitorëve vendas apo të huaj dhe të minojë besimin e publikut tek institucionet financiare. Në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, në datën 30 tetor 2025 është zhvilluar një tryezë diskutimi mbi informimin dhe ndërgjegjësimin në sektorin FinTech, organizuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri, në të cilën morën pjesë rreth 51 pjesëmarrës. Diskutimet u fokusuan tek sfidat dhe mundësitë që sjell teknologjia financiare në parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.		

				Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, sektori privat, institucionet publike dhe profesionistë ligjorë. Temat e këtij takimi përfshinin: – Bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave për një sektor FinTech të sigurt dhe të qëndrueshëm; – Dixhitalizimit dhe inovacionit në sistemin financiar, duke garantuar monitorimin e transaksioneve dhe transparencën; – Rregullave dhe kornizës ligjore për të menaxhuar rreziqet e teknologjisë financiare; – Ndërgjegjësimit publik për përdorimin e sigurt të shërbimeve financiare dhe parandalimin e mashtrimeve financiare. Takimi përfundoi me një diskutim interaktiv mbi strategjitë e mbrojtjes dhe rolin e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm. *3. Lidhur me Publikime në faqen zyrtare të AIF dhe në rrjetet sociale, në funksion të ndërgjgjësimit të publikut dhe institucioneve shtetërore dhe private:* AIF pasqyron aktivitetin veçanërisht në faqen zyrtare të internetit, si dhe në rrjetin profesional LinkedIn, ku publikon rregullisht informacione, njoftime dhe materiale informuese që synojnë rritjen e transparencës, informimin e saktë dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe të institucioneve, në fushën e parandalimit të parandalimit të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit/financimit të përhapjës së armëve të dëmtimit në masë, ku sipas llojit të aktivitetit pasqyrohen edhe ato të lidhura me dezinformimit.		
2.	09.01.2026	Kërkesë me email-organziatë 1.A ka marrë institucioni juaj RAD për OJF gjatë vitit 2025 nga subjektet raportuese lidhur me dyshime për financim terrorizmi ? Nëse po lutem listoni nr. e RAD sipas subjekteve raportuese? 2.Nëse ka patur RAD/RTD për OJF cilat janë tipologjitë e tyre? Sa	21.01.2026	*1.A ka marrë institucioni juaj RAD për OJF gjatë vitit 2025 nga subjektet raportuese lidhur me dyshime për financim terrorizmi ? Nëse po lutem listoni nr. e RAD sipas subjekteve raportuese?* *2.Nëse ka patur RAD/RTD për OJF cilat janë tipologjitë e tyre? Sa nga këto raste janë dërguara në organet ligj zbatuese?* Në lidhje me pikën 1 dhe 2, informojmë se Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) gjatë 2025 nuk ka marrë RAD nga subjekte raportuese me dyshime për financim terrorizmi të lidhura me një OJF.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

		nga këto raste janë dërguara në organet ligj zbatuese? 3. A disponon institucioni juaj të dhëna për raste ku OJF kanë patur kufizime nga institucione financiare banke dhe jo bankë për aksesimin e fondeve me burim të huaj. Nëse po sa raste kanë qenë? 4. A ka nxjerrë institucioni juaj urdhër bllokimi të përkohshëm për llogari bankare të OJF për raste e RAD/RTD ? Nëse po cila është shuma e sekuestruar? 5. A ka organizuar institucioni juaj takime për të rritur ndërgjegjësimin e OJF mbi PP/FT? Nëse po lutemi të siguroni të dhëna në lidhje me: - Mënyrën e informimit; - Mënyrën dhe formën; - Numrin e organizatave të njoftuara; - Numrin e organizatave pjesëmarrëse në këto takime.		*3. A disponon institucioni juaj të dhëna për raste ku OJF kanë patur kufizime nga institucione financiare banke dhe jo bankë për aksesimin e fondeve me burim të huaj. Nëse po sa raste kanë qenë?* AIF nuk disponon informacion mbi raste të kufizimeve të OJF nga institucione financiare banke dhe jo bankë për aksesimin e fondeve me burim të huaj. *4. A ka nxjerrë institucioni juaj urdhër bllokimi të përkohshëm për llogari bankare të OJF për raste e RAD/RTD ? Nëse po cila është shuma e sekuestruar?* Për sa i përket pikës 4, gjatë 2025 nga AIF nuk janë nxjerrë urdhra bllokimi të përkohshëm për ngrirjen e transaksioneve ose të veprimit financiar, të lidhura me OJF. *5. A ka organizuar institucioni juaj takime për të rritur ndërgjegjësimin e OJF mbi PP/FT? Nëse po lutemi të siguroni të dhëna në lidhje me:* • Mënyrën e informimit; • Mënyrën dhe formën; • Numrin e organizatave të njoftuara; • Numrin e organizatave pjesëmarrëse në këto takime. Në kuadër të ndërgjegjësimit mbi PP/FT/FPADM (financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë) përfshirë edhe OJF në faqen zyrtare[1] të AIF rezultojnë të publikuara një sërë dokumentesh që shërbejnë ndërgjegjësimit të OJF si: Udhëzues për organizatat jofitimprurëse, Tipologji të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave nëpërmjet keqpërdorimit të OJF, Udhëzues për zbatimin e sanksioneve financiare të lidhura me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, Raportet Vjetore ndër vite të AIF të cilat përmbajnë tipologji të larmishme etj. Në kuadër të Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP), ngritur nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) në Dhjetor 2023		

[1] https://fiu.gov.al/publikime-aktivitete/publikime/

				si një strukturë e posaçme në funksion të rritjes së efektivitetit të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe me qëllim forcimin e partneritetit publik privat, anëtarë të GTNP **janë edhe 10 përfaqësues të sektorit privat,** kryesisht përfaqësues të subjekteve raportuese në kuadër të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, konkretisht: *Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Shoqata e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme (NAREA), Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Shoqata e Agjencive të Këmbimit Valutor (AFEA), Shoqata Shqiptare e Ndërtuesve, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë.* Janë anëtarë aktiv të GTNP, pjesëmarrës në të gjitha takimet e realizuar, ku vetëm për 2025 janë organizuar 6 takime të tilla. Gjithashtu gjatë vitit 2025 në mënyrë të veçantë AIF ka bashkë organizuar 2 takime ndërgjegjësuese që kanë patur në qendër të tyre rritjen e ndërgjegjësimit të OJFve në fushën e PP/FT, konkretisht: Në datë 21.05.2025 AIF në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA) dhe me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (DHTIT) zhvilloi një tryezë diskutimi mbi "*Strategjinë e edukimit të publikut mbi rrezikun që mbart në shoqërinë tonë pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit 2025–2027*" duke u përqendruar në rolin që duhet të luajnë jo vetëm institucionet shtetërore, por edhe shoqëria civile, institucionet arsimore, media dhe sektori privat. Në këtë takim kanë marrë pjesë 15 OJF, konkretisht: *SHGPAZ, Instituti për Kontratën Shoqërore, Center for the Study of Democracy and Governance, Albanian Center for Economic Research (ACER), Gender Alliance for Development Centre (GADC), Instituti për Ndërmjetësim dhe Demokraci (IDM), IOM Albania, Council of Europe Office in Tirana, Partners Albania for Change and Development, PPNEA, Together For Life, SHKIZH (Shoqata Kombëtare për Integrim, Zhvillim dhe Ndihmë për Shtresat në Nevojë), European Movement Albania, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Urban Research Institute.* Në datë 30 tetor 2025, u zhvillua një tryezë diskutimi mbi informimin dhe ndërgjegjësimin në sektorin FinTech, organizuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA), në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian. *Diskutimet u fokusuan në sfidat dhe mundësitë*		

<table>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>që ofron teknologjia financiare në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, si edhe në trajtimin e çështjeve që lidhen me dezinformimin, një problematikë me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga institucionet publike, sektori privat, shoqëria civile dhe profesionistë ligjorë, të cilët shkëmbyen ide dhe përvoja mbi zhvillimet në sektorin financiar. Në takimin e datës 30 Tetor kanë marrë pjesë 7 OJF, konkretisht: Center for Research and Excellence, Partners Albania, Albanian Helsinki Committee, European Movement Albania, Institute for Science Education and Dev. Policies, EËMI, Akademia e Integrimit Evropian dhe Negociatave.</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="7">Shkurt 2026-Nuk ka kërkesa për informacion</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>09.03.2026</td><td>Kërkesë me email-individ

1.Rastet e Aktivitetit të dyshimtë të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2020–2025;
2. Rastet e dërguara në organet ligjzbatuese për periudhën 2020–2025;
3. Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2025 në DPPSH dhe Prokurori;
4. Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet në vlerë për periudhën 2020–2025.
5. Kundërvatjet administrative të shqyrtuara sipas kategorive të subjekteve dhe masat e marra për to në vitin 2025;
6. Sektorët më me risk në pastrimin e parave që vlerëson Agjencia e Inteligjencës Financiare:</td><td>12.03.2026</td><td>Jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion, për të cilën ju informojmë si vijon:

1. Lidhur me pyetjen 1: Rastet e Aktivitetit të dyshimtë të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2020–2025:

Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD) të raportuara në Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF), sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2020 – 2025:

<table>
<tr><th>Subjekti raportues</th><th>2020</th><th>2021</th><th>2022</th><th>2023</th><th>2024</th><th>2025</th></tr>
<tr><td>Banka</td><td>703</td><td>725</td><td>660</td><td>756</td><td>718</td><td>750</td></tr>
<tr><td>Shoqëri transfertash</td><td>315</td><td>290</td><td>293</td><td>323</td><td>365</td><td>331</td></tr>
<tr><td>DPD</td><td>44</td><td>33</td><td>25</td><td>24</td><td>8</td><td>12</td></tr>
<tr><td>DPT</td><td>10</td><td>6</td><td>9</td><td>8</td><td>4</td><td>25</td></tr>
<tr><td>ASHK</td><td>0</td><td>16</td><td>22</td><td>29</td><td>33</td><td>8</td></tr>
<tr><td>Noter</td><td>321</td><td>482</td><td>735</td><td>516</td><td>413</td><td>486</td></tr>
<tr><td>ZKV</td><td>4</td><td>4</td><td>9</td><td>32</td><td>19</td><td>75</td></tr>
<tr><td>Inst. financiare të mikro-kredisë</td><td>9</td><td>17</td><td>28</td><td>21</td><td>16</td><td>26</td></tr>
<tr><td>Shoqëri të qiradhënies financiare</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>5</td><td>6</td><td>6</td></tr>
<tr><td>Shoqëri ndërtimi</td><td>2</td><td>2</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>0</td></tr>
</table></td><td>Përfunduar/ dërguar përgjigje me email</td><td>Jo</td></tr>
</table>

Shoqëri tregtimi mjetesh motorike	0	0	3	3	8	3				
Shoqëri pagesash elektronike	0	0	1	1	26	25				
Avokat	0	1	0	0	0	0				
Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme	0	0	0	1	5	5				
Shoqëri transporti	1	0	0	0	0	0				
Fond investimi	0	0	0	1	0	3				
Shoqëri pagesash/Posta Shqiptare	0	3	5	7	9	1				
Lojra Fati	0	0	0	0	2	2				
Tjetër	0	1	0	0	0	1				
Total	**1,409**	**1,581**	**1,790**	**1,728**	**1,632**	**1,759**				

2. Lidhur me pyetjen 2: Rastet e dërguara në organet ligjzbatuese për periudhën 2020–2025:

Rastet e dërguara në organet ligj zbatuese për periudhën 2020 – 2025:

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Prokurori të të Juridiksionit të Përgjithshëm	26	21	13	19	31	24
SPAK	15	29	10	26	36	32
Polici	227	208	201	174	167	133
DPT	43	24	19	19	25	80
Total	311	282	243	238	259	269

3. Lidhur me pyetjen 3: Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2025 në DPPSH dhe Prokurori:

Për sa i përket indicieve fillestare për rastet e referuara nga AIF pranë agjencive ligjzbatuese, rezulton se burimi kryesor mbeten RAD e paraqitura nga subjektet e ligjit, të cilat kanë shërbyer si pikënisje për rreth 83% të rasteve. Pjesa e mbetur

përbëhet nga raste të iniciuara mbi bazën e analizave strategjike/sektoriale që AIF realizon, si dhe burime të tjera.

Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2025 në DPPSH, Prokurori dhe DPT:

Indiciet	RAD	NjIF Partnere	Analiza Strategjike	Burime të hapura	Kërkesa nga institucione	Total
Raste të dërguara në Prokurori	51	0	3	1	1	56
Raste të dërguara në Polici	95	1	34	1	2	133
Raste të dërguara në DPT	79	0	1	0	0	80
Total	225	1	38	2	3	269

4. Lidhur me pyetjen 4: Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet në vlerë për periudhën 2020–2025

Në rastet kur AIF ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për PP/FT, në funksion të parandalimit të tjetërsimit të produkteve financiare kriminale, urdhëron bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë dhe informon prokurorinë kompetente dhe sipas rastit organe të tjera të zbatimit të ligjit.

Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2020 – 2025:

Viti	Nr. i urdhrave të bllokimit nga AIF	Pasuria totale e bllokuar (EUR)	Pasuria totale e sekuestruar (EUR)	Raporti sekuestrime/ bllokime
2020	7	1,172,291	1,172,886	100%
2021	3	250,240	200,000	80%
2022	3	2,426,882	2,426,882	100%
2023	4	1,178,350	1,100,350	93%
2024	11	10,751,684	10,418,238	97%

2025	8	793,375	763,375	96%

5. Lidhur me pyetjen 5: Kundërvatjet administrative të shqyrtuara sipas kategorive të subjekteve dhe masat e marra për to në vitin 2025:

Gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar praktika administrative për të cilat janë propozuar kundërvajtje administrative gjatë procedurave inspektuese. Për 27 prej tyre është konkluduar me masën administrative "gjobë", 37 me masën administrative "paralajmërim".

Subjektet	VITI 2025 Masa administrative "Gjobë"	Masa administrative "Paralajmërim"
Noter	4	12
ZKV	8	7
Shoqëri auditimi	1	-
Shoqëri udhëtimi	2	1
Ndërmjetësuese Pasurish	1	4
IFJB	3	3
Shoqëri ndërtimi	5	6
Shoqëri tregtimi mjete motorike	1	2
Shoqëri sigurimi jetë	1	-
Shoqëri tregtimi i metaleve dhe gurëve	1	1
Lojra fati	-	1

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>TOTAL</td><td>27</td><td>37</td></tr>
</table>

6. Lidhur me pyetjen 6: Sektorët më me risk në pastrimin e parave që vlerëson Agjencia e Inteligjencës Financiare:
Përveç të dhënave që gjenden në raportet vjetore lidhur me tipologjitë e rasteve të dyshuara, AIF ka publikuar në faqen e internetit edhe një përmbledhje të Vlerësimit Kombëtar të Riskut, miratuar në dhjetor të vitit 2023, ku janë të përcaktuar edhe sektorët me risk.
https://fiu.gov.al/ëp-content/uploads/2024/03/Vleresimi_Kombetar_Riskut.pdf
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>4.</td>
<td>18.03.2026</td>
<td>Kërkesë me email-individ</td>
<td>26.03.2026</td>
<td>
Jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion, për të cilën ju informojmë si vijon:

1. Sa raporte të transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta janë marrë që lidhen me baste sportive, lojëra fati ose operatorë të kësaj fushe, për dy vitet e fundit?
Në lidhje me këtë pikë informojmë se, në një vlerësim rastet me tipologji të tillë janë 12 raste për periudhën Janar 2024 - Dhjetor 2025.

2. Cilat kategori subjektesh raportuese kanë sinjalizuar më shpesh raste të tilla?
Raste me tipologji të tilla janë raportuar nga bankat që operojnë në vend në rastet kur kemi përdorim të llogarive bankare dhe në raste sporadike nga subjektet kazino.

3. Sa raste janë referuar nga AIF te Policia, SPAK ose Prokuroria që lidhen me baste/lojëra fati?

Për periudhën 2024-2025, nga AIF janë shpërndarë në organe ligjzbatuese 4 (katër) raste.

4. A ka AIF tipologji apo red flags specifike për përdorimin e basteve sportive në pastrim parash?
Agjencia i Inteligjencës Financiare në raportin e saj vjetor (linku: https://fiu.gov.al/raporte/) publikon tipologji të ndryshme, ndër to gjenden edhe tipologji të lidhura me lojërat e fatit si Tipologjia 1 në RV 2024.

5. A konsiderohet ky sektor me risk të lartë në vlerësimet e brendshme të AIF?</b
</td>
<td>Përfunduar/ dërguar përgjigje me email</td>
<td>Jo</td>
</tr>
</table>

				Sipas Vlerësimit të fundit Kombëtar të Riskut (miratuar në Dhjetor 2023, sipas metodologjisë së Këshillit të Europës) për pastrim parash dhe financim terrorizmit, sektori i lojërave të fatit kanë rezultuar me risk mesatar për pastrim parash.		
5.	28.04.2026	Kërkesë me email-individ 1. Kopje të udhëzimeve, shkresave mbi tipologjitë e rrezikut të shpërndara te subjektet raportuese (banka, noterë, agjentë imobiliarë, etj.) lidhur me identifikimin e fondeve apo aseteve që i nënshtrohen sanksioneve ndaj Federatës Ruse (2022-2026). 2. Numrin e "Urdhrave të Bllokimit të Përkohshëm" të lëshuara nga AIF për asetet, fondet apo transaksionet e lidhura specifikisht me individë ose entitete ruse të sanksionuara. 3. Të dhëna statistikore mbi numrin dhe vlerën e Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta (SAR) të marra dhe analizuara nga AIF, që kanë pasur si objekt specifik dyshimin për shkelje ose shmangie të sanksioneve ndaj Rusisë.	04.05.2026	**Lidhur me pyetjen 1:** Kopje të udhëzimeve, shkresave mbi tipologjitë e rrezikut të shpërndara te subjektet raportuese (banka, noterë, agjentë imobiliarë, etj.) lidhur me identifikimin e fondeve apo aseteve që i nënshtrohen **sanksioneve ndaj Federatës Ruse** (2022-2026). Agjencia e Inteligjencës Financiar në muajin Shtator të vitit 2025 ka përditësuar Udhëzuesin për "Sanksionet Financiare të Lidhura Me Terrorizmin, Financimin të Terrorizmit dhe Financimin e Përhapjes në Armëve të Dëmtimit në Masë" i cili paraqet në mënyrë të detajuar çfarë janë sanksionet e synuara financiare, detyrimet për zbatimin e tyre, fondet dhe pasuritë të cilat i nënshtrohen ngrirjes, masat parandaluese, procedurat e listimit, raportimi pranë AIF, si dhe disa tregues të financimit të terrorizmit dhe Armëve të Dëmtimit në Masë. Një kopje të udhëzuesit e gjeni në faqen e internetit të AIF: https://fiu.gov.al/ëp-content/uploads/2025/10/Udhezuesi-per-sanksionet-kunder-financimit-te-terrorizmit-Shtator-2025.pdf Gjithashtu në faqen e internetit të AIF, janë publikuar tipologji të financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë, të cilat përfshijnë dhe tipologji të shmangies së sanksioneve, transaksione me vende, subjekte të sanksionuara, të cilat gjenden në si më poshtë: https://fiu.gov.al/ëp-content/uploads/2024/02/Tipologji-per-financimin-e-terrorizmit.pdf. **Lidhur me pyetjen 2:** Numrin e "Urdhrave të Bllokimit të Përkohshëm" të lëshuara nga AIF për asetet, fondet apo transaksionet e lidhura specifikisht me individë ose entitete ruse të sanksionuara. Bazuar në ligjin nr. 72/2019 "Për masat shtrënguese ndërkombëtare" i ndryshuar, autoritetet përgjegjëse për masat shtrënguese me karakter financiar janë ministria përgjegjëse për financat dhe strukturat në varësi të saj, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**.** Republika e Shqipërisë vendos, zbaton, ndryshon ose	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	jo

				shfuqizon në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendimet e miratuara nga organizatat ndërkombëtare, në të cilat ajo është shtet anëtar. Gjithashtu, në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria ndjek parimin e harmonizimit dhe përputhshmërisë me aktet ligjore dhe vendimet e BE, duke i integruar ato në kuadrin legjislativ vendas. AIF nuk ka marrë njoftime nga subjektet e ligjit për fonde apo pasuri të bllokuara prej tyre në zbatim të dispozitave ligjore të sipërpërmendura. Për rrjedhojë, bazuar në fushën e saj të përgjegjësisë, AIF nuk ka lëshuar urdhra bllokimi të përkohshëm lidhur me individë apo subjekte ruse të sanksionuara. **Lidhur me pyetjen 3:** Të dhëna statistikore mbi numrin dhe vlerën e Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta (SAR) të marra dhe analizuara nga AIF, që kanë pasur si objekt specifik dyshimin për shkelje ose shmangie të sanksioneve ndaj Rusisë. Gjatë periudhës 2022- Prill 2026, pranë AIF janë raportuar rreth 25 Raporte të Aktivitet të Dyshimtë, të cilat kanë pasur përfshirje të shtetasve/subjekteve/mallrave nga Federata Ruse, por rastet nuk lidhen me individë/subjekte/mallra të sanksionuar sipas legjislacionit në fuqi në vendin tonë.		
6.	29.04.2026	Kërkesë me email-gazetar 1. A keni kryer ju si Agjenci e Inteligjencës Financiare, kërkime të mëparshme ne lidhje me x? 2. Si është e mundur që një person i vetëm disponon x pasuri? 3. A keni kryer ju raportime nëse keni patur dyshime për paratë dhe pronat e të pandehurve të grupit të x? 4. Cili është roli juaj si institucion për parandalimin e pastrimit të	04.05.2026	Në funksion të shqyrtimit të kërkesës suaj, me anë të së cilës kërkoni informacion për individë konkret, vlerësojmë të nevojshme të evidentojmë disa nga parashikimet përkatëse të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si më poshtë vijon: • bazuar në nenin 22, “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”, AIF shkëmben informacion me prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështje që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtarinë kriminale që gjeneron produkte të veprës penale, si dhe financimin e terrorizmit; • bazuar në nenin 21, “Organizimi i autoritetit përgjegjës”, pika 1/1, “Përdorimi i të dhënave”, parashikohet se: “Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së personelit apo sistemeve në	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	jo

		parave, në këtë çështje konkrete? Keni një koment?		përdorim, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional. Agjencia e Inteligjencës Financiare duhet të arsyetojë kufizimin rast pas rasti."; • në nenin 22/1, "Përdorimi i të dhënave", përcaktohet se: "Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror (...)". Më tej, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, ndër të tjera, parashikohet se: • sipas nenit 2, pika 16, "Nevojë për njohje" është nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar gjatë ushtrimit të një funksioni të caktuar, me qëllim përmbushjen e një detyre zyrtare; • sipas nenit 3, ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, për të cilët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe bazuar në parimin "nevojë për njohje", kërkohet qasje në informacion të klasifikuar; • sipas nenit 19, pika 1, shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar kryhet me qëllim ushtrimin e një detyre, në bazë të parimit "nevojë për njohje", me miratim të titullarit të institucionit përkatës dhe vetëm nga persona të certifikuar përshtatshmërisht. Gjithashtu, sipas parashikimeve të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, neni 17, pika 2, e drejta e informimit kufizohet edhe në rastet që lidhen me sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar, si dhe në rastet që lidhen me parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë parashikimet ligjore të sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa juaj nuk përmbush kriteret ligjore për njohjen me një informacion të tillë. Në veçanti, nuk rezulton që Ju, si kërkues, të jeni organ i përcaktuar nga ligji për shkëmbimin e këtij informacioni, të provoni interesin përkatës ligjor në kuptim të fushës së përgjegjësisë, të përmbushni parimin "nevojë për njohje", apo të keni certifikatën përkatëse të sigurisë për akses në informacion të klasifikuar.		

				Për sa më sipër, kërkesa juaj nuk mund të përmbushet, pasi nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore të zbatueshme.		
7.	21.05.2026	Kërkesë për informacion me shkresë dhe email -qytetar Lidhur me deklasifikimin e shkresës nr. xx datë xxx	03.06.2026	1. Në lidhje me pikën 1 të shkresës tuaj ju sqarojmë se: Klasifikimi i shkresës X është realizuar në përputhje të plotë me parashikimet ligjore, duke u shpjeguar si më poshtë: - Ligji Nr. 9917, datë 19.5.2008 "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"* i ndryshuar, i cili përben kornizën kryesore të veprimtarisë së AIF si dhe është ligj i posaçëm, parashikon: ▪ neni 21 pika 1, AIF "*brenda fushës së veprimtarisë së vet ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave (..*); ▪ neni 22 germa "e", AIF "*<u>shkëmben informacion me</u> prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimit të terrorizmit, si dhe mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe më to*"; ▪ neni 22/1 paragrafi i parë "*<u>Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar</u> nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për organet e zbatimit të ligjit, <u>i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror</u> <u>dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale".</u>* - Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, "*Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror*", të ndryshuar, akti ligjor në fuqi në kohën e çështjes në diskutim. Sa më sipër vlen të theksohet se informacioni i përcjellë nga AIF tek organet e zbatimit të ligjit trajtohet sipas regjimit juridik të informacionit të klasifikuar dhe administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës. 2. Në lidhje me pikën 2 të shkresës tuaj ju sqarojmë se: Neni 21/1 i ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar, parashikon se Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime ndaj të dhënave të kërkuara në	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email dhe shkresë	Jo

				funksion të së drejtës për informim, kur kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional, duke arsyetuar rast pas rasti. Në rastin konkret, kufizimi nuk është vendosur për shkak të interesit privat të personave të përfshirë në çështje, por për shkak të natyrës së informacionit të administruar dhe të përcjellë nga AIF tek organet kompetente të zbatimit të ligjit, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore. Vlerësimi i proporcionalitetit është bërë duke pasur parasysh: ▪ detyrimin ligjor të AIF për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të burimeve të informacionit të administruar bazuar mbi të dhënat e inteligjencës financiare; ▪ detyrimin për mbrojtjen e informacionit të shkëmbyer me organet ligj zbatuese; ▪ faktin se informacioni i përcjellë nga AIF nuk përbën provë në kuptim të Kodit të Procedurës Penale; ▪ nevojën për të garantuar integritetin e mekanizmave ligjorë të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimin e mospërhapjes të armëve të dëmtimit në masë. Për rrjedhojë, kufizimi i aksesit ndaj shkresës nuk është vendosur për të fshehur apo mbrojtur veprimtarinë e ndonjë personi të caktuar, por në zbatim të detyrimeve ligjore që rregullojnë administrimin e informacionit të trajtuar nga AIF. Në këto kushte, Agjencia vlerëson se kufizimi i aplikuar ka qenë i bazuar në ligj, i domosdoshëm për mbrojtjen e informacionit të administruar në kuadër të funksioneve të saj dhe proporcional me interesat që synon të mbrojë legjislacioni në fuqi. 3. Në lidhje me pikën 3 të shkresës ju sqarojmë se: Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, në fuqi në kohën e klasifikimit, parashikonte ndër të tjera, në nenin 6 pikat c)[1] se informacioni i nënshtrohej procesit të klasifikimit edhe kur lidhej me veprimtarinë e shërbimeve informative, format dhe metodat e punës, si dhe burimet dhe procedurat e përdorura në administrimin e informacionit.		

[1] c) *veprimtari të shërbimeve informative, me forma dhe metoda të punës, me kriptologji në objektet e mjetet teknike, në vendet ku përpunohet dhe arkivat ku ruhet informacioni,*

				Në këtë kuptim, vlerësimi për klasifikimin nuk lidhet vetëm me natyrën e faktit apo transaksionit të referuar në dokument, por veçanërisht me nevojën për mbrojtjen e informacionit të administruar nga autoriteti përgjegjës (në ketë rast AIF - ish DPPPP) metodologjisë së analizës, burimeve të informacionit dhe mekanizmave institucionalë të përdorur në ushtrimin e funksioneve ligjore të tij. Gjithashtu, neni 22/1 i ligjit nr. 9917/2008, i ndryshuar, parashikonte se informacioni i dërguar nga Agjencia tek organet e zbatimit të ligjit i nënshtrohet legjislacionit për informacionin e klasifikuar, duke vendosur një regjim të posaçëm juridik për trajtimin e këtij informacioni. Për rrjedhojë, nuk rezulton asnjë mospërputhje ndërmjet klasifikimit të shkresës dhe dispozitave të legjislacionit për informacionin e klasifikuar, në fuqi në kohën e klasifikimit dhe aktualisht. Nga ana tjetër, bazuar në Ligjin nr. 9917/2018 "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*", i ndryshuar, neni 21 pika 2 dhe neni 22 shkronja "a" AIF vepron si njësi e inteligjencës financiare, e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek institucionet e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. AIF nuk ka kompetencat e organit hetimor, por në bazë të nenit 22 germa "e" shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimit të terrorizmit. Gjithashtu bazuar në nenin 22/1, paragrafi i parë, i po këtij ligji, përcaktohet se "*Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe <u>nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale</u>*.. Në përmbledhje të sa më sipër duhet të theksohet fakti që çdo informacioni që AIF ndan me organet kompetente ligj zbatuese nuk mund të përdoret si provë. Në këtë kuadër AIF, bazuar në kompetencat ligjore, e ka ndarë këtë informacion me organet përkatëse ligj zbatuese, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Shtetit (dhe jo vetëm) e cila e ka referuar në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.		

				Në lidhje me këtë rast, sugjerojmë që Ju mund ti drejtoheni organit të prokurorisë për të marrë informacion të mëtejshëm mbi dosjen dhe dokumentacionin e administruar në të, si dhe mbi ecurinë e mëtejshme të rastit.		
8.	05.06.2026	Kërkesë me email-qytetar Kërkesë për dorëzimin në gjykatë të shkresës X	09.06.2026	Duke vlerësuar interesimin tuaj të vazhdueshëm, si dhe në përgjigje të shkresës suaj, me anë të së cilës kërkoni dorëzimin pranë Gjykatës X të shkresës X, dhe informacion lidhur me mundësinë e administrimit të saj në kushtet e informacionit të klasifikuar, ju bëjmë me dije sa vijon: Duke qenë se çështja në shqyrtim pranë Gjykatës ka natyrë civile dhe zhvillohet ndërmjet palëve private, pa pasur si objekt shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimtarisë apo akteve të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, vlerësojmë se shkresa X, në përputhje dhe me nenin 22/1 të ligjit nr. 9917/2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit", i ndryshuar, nuk mund të vihet në dispozicion apo të administrohet jashtë kuadrit ligjor që rregullon informacionin e klasifikuar. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se kompetenca për klasifikimin, rishikimin ose deklasifikimin e informacionit të klasifikuar ushtrohet vetëm në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, parashtruar dhe në komunikimet zyrtare të mëparshme. Për rrjedhojë, as vënia në dispozicion dhe as administrimi i informacionit të klasifikuar nuk mund të realizohen jashtë procedurave dhe rasteve të parashikuara shprehimisht nga ky legjislacion. Për sa më sipër, Agjencia e Inteligjencës Financiare vlerëson se qëndrimi i saj institucional është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe mbetet e gatshme për çdo komunikim të mëtejshëm në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email dhe shkresë	Jo
9.	15.06.2026	Kërkesë me email-gazetar 1. A ka kryer AIF verifikime lidhur me transaksionet financiare të X? 2. A ka administruar ose analizuar AIF raportime per transaksione të dyshimta që mund të lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi lidhur me x?	17.06.2026	Në funksion të shqyrtimit të kërkesës suaj, me anë të së cilës kërkoni informacion për një çështje konkrete, vlerësojmë të nevojshme të evidentojmë disa nga parashikimet përkatëse të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, si më poshtë vijon: • bazuar në nenin 22, "Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës", AIF shkëmben informacion me prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështje që lidhen me pastrimin e produkteve	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

		3. A janë identifikuar modele ose volume transaksionesh që kanë kërkuar vëmendje të shtuar nga autorietet në lidhje me x? 4. A kanë qënë bankat e nivelit të dytë pjesë e proceseve të financimit, kredimit apo garanntimit të transaskioneve që lidhen me x? 5. Në se po, cili ka qenë roli i insitucioneve bankare në këto transaksione dhe a janë respektuar procedurat e parandalimit të pastrimit të parave dhe njohjes së klientit? 6. A ka referuar AIF ndonjë rast, informacion apo raport lidhur me x pranë organeve ligjzbatuese ose institucioneve të tjera kompetente?		të veprës penale, veprat penale ose veprimtarinë kriminale që gjeneron produkte të veprës penale, si dhe financimin e terrorizmit; • bazuar në nenin 21, "Organizimi i autoritetit përgjegjës", pika 1/1, "Përdorimi i të dhënave", parashikohet se: "Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së personelit apo sistemeve në përdorim, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional. Agjencia e Inteligjencës Financiare duhet të arsyetojë kufizimin rast pas rasti."; • në nenin 22/1, "Përdorimi i të dhënave", përcaktohet se: "Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror (...)". Më tej, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, ndër të tjera, parashikohet se: • sipas nenit 2, pika 16, "Nevojë për njohje" është nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar gjatë ushtrimit të një funksioni të caktuar, me qëllim përmbushjen e një detyre zyrtare; • sipas nenit 3, ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, për të cilët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe bazuar në parimin "nevojë për njohje", kërkohet qasje në informacion të klasifikuar; • sipas nenit 19, pika 1, shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar kryhet me qëllim ushtrimin e një detyre, në bazë të parimit "nevojë për njohje", me miratim të titullarit të institucionit përkatës dhe vetëm nga persona të certifikuar përshtatshmërisht. Gjithashtu, sipas parashikimeve të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, neni 17, pika 2, e drejta e informimit kufizohet edhe në rastet që lidhen me sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar, si dhe në rastet që lidhen me parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë parashikimet ligjore të sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa juaj nuk përmbush kriteret ligjore për njohjen me një		

				informacion të tillë. Në veçanti, nuk rezulton që Ju, si kërkues, të jeni organ i përcaktuar nga ligji për shkëmbimin e këtij informacioni, të provoni interesin përkatës ligjor në kuptim të fushës së përgjegjësisë, të përmbushni parimin "nevojë për njohje", apo të keni certifikatën përkatëse të sigurisë për akses në informacion të klasifikuar. Për sa më sipër, kërkesa juaj nuk mund të përmbushet, pasi nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore të zbatueshme.		
10.	06.07.2026	Kërkesë me email – qytetar Kërkesë për deklasifikim te pjesshem informacioni dhe shqyrtim te ligjshmerise se klasifikimit dhe mosdeklasifikimit lidhur me shkresën 500/4 prot., datë 26.06.2019	17.07.2026	**1.Mbi legjitimimin aktiv** Agjencia e Inteligjencës Financiare bën me dije se ndryshimi i subjektit kërkues nuk ndikon në natyrën e informacionit të klasifikuar dhe as në regjimin ligjor të trajtimit të tij pasi kriteret e klasifikimit dhe të deklasifikimit vlerësohen në raport me përmbajtjen e informacionit dhe jo me identitetin e kërkuesit. **2. Mbi ndryshimin e kuadrit ligjor** Klasifikimi i shkresës nga është kryer në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në kohën e klasifikimit, konkretisht me ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", të ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ndryshimi i këtij kuadri ligjor, shfuqizimi i ligjit nr. 8457/1999 me ligjin nr. 10/2023 dhe zëvendësimi i VKM-ve përkatëse me VKM nr. 822, datë 26.12.2024, nuk e cenon ligjshmërinë e klasifikimit të kryer sipas legjislacionit në fuqi në kohën e tij. Nga ana tjetër, edhe legjislacioni aktual i ruan si kategori të klasifikueshme veprimtarinë e strukturave informative, burimet e informacionit dhe dokumentacionin e krijuar gjatë veprimtarisë parandaluese, gjurmuese dhe zbuluese, sipas nenit 10 të ligjit nr. 10/2023. Rrjedhimisht, klasifikimi mbetet në përputhje edhe me kuadrin e ri ligjor. **3. Mbi pajtueshmërinë e klasifikimit me kategoritë ligjore** Nga dokumentacioni administrativ i administruar rezulton se shkresa është klasifikuar duke u mbështetur në kategoritë e informacionit të parashikuar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, veçanërisht ato që lidhen me veprimtarinë e institucioneve që ushtrojnë funksione informative, burimet e informacionit dhe dokumentacioni i krijuar gjatë veprimtarisë informuese, parandaluese, gjurmuese dhe zbuluese.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email shkresë	Jo

				Po ashtu, klasifikimi qëndron në pajtim me nenet 4, 9 dhe 11 të ligjit nr. 10/2023. Informacioni lidhet me sigurinë kombëtare në kuptim të nenit 4, pika 18, pasi prek veprimtarinë parandaluese, gjurmuese dhe zbuluese të Agjencisë; ekspozimi i tij i paautorizuar do t'i shkaktonte dëme serioze kësaj veprimtarie. **4.** Rrezikun konkret për sigurinë kombëtare, e përbën fakti se ekspozimi i paautorizuar i këtij dokumenti do të komprometonte metodologjinë e analizës, burimet e informacionit dhe kanalet e shkëmbimit të inteligjencës financiare me organet ligjzbatuese. Një komprometim i tillë do të dëmtonte aftësinë parandaluese dhe zbuluese të Agjencisë dhe integritetin e mekanizmit kombëtar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, interes ky që lidhet drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 10/2023. Kujtojmë gjithashtu se, sipas nenit 22/1 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, çdo informacion i dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale. **5. Mbi hierarkinë e akteve normative** Vlerësimet e shprehura në korrespondencën me ju janë bërë në zbatim të ligjit nr. 10/2023 dhe të akteve nënligjore të dala në funksion të tij, pa asnjë konflikt normash dhe në harmoni të plotë me nenin 116 të Kushtetutës. **6. Mbi nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 10/2023** Sikurse është argumentuar në pikat 4 dhe 5 më sipër, klasifikimi i shkresës në fjalë është kryer brenda kategorive ligjore, ndaj këto dispozita nuk gjejnë zbatim në rastin konkret. **7.** AIF e ka shqyrtuar kërkesën duke marrë në konsideratë njëkohësisht të drejtën për informim, detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar dhe ligjin e posaçëm nr. 9917/2008. Neni 21, pika 1, i këtij ligji nuk është interpretuar dhe nuk zbatohet si dispozitë që prevalon mbi ligjet nr. 119/2014 dhe nr. 10/2023 pasi këto akte zbatohen në harmoni me njëri-tjetrin, ku ligji i posaçëm përcakton fushën e veprimtarisë së Agjencisë, ndërsa legjislacioni për informimin dhe për informacionin e klasifikuar përcakton kufijtë dhe procedurat e aksesit në informacion.		

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>

8. Mbi parimin e proporcionalitetit

Neni 21/1 i ligjit nr. 9917/2008 parashikon se AIF mund të vendosë kufizime ndaj të dhënave të kërkuara në funksion të së drejtës për informim, kur kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional, duke arsyetuar rast pas rasti. Vlerësimi i proporcionalitetit në rastin konkret, në përputhje edhe me kriteret e nenit 12 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe me nenin 17 të Kushtetutës, është bërë duke pasur parasysh:

– detyrimin ligjor të AIF për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të burimeve të informacionit të administruar;
– detyrimin për mbrojtjen e informacionit të shkëmbyer me organet ligjzbatuese;
– faktin se informacioni i përcjellë nga AIF nuk përbën provë në kuptim të Kodit të Procedurës Penale;
– nevojën për të garantuar integritetin e mekanizmave ligjorë të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>11.</td>
<td>08.07.2026</td>
<td>

Kërkesë me shkresë-gazetar

1. A ka informuar AIF pranë SPAK për mjete financiare, të ardhura ose pasuri gjatë viteve 2020-2026 sipas parashikimit të nenit 30 pika 1. a) e ligjit 95/2016? Nëse po, sa raste ka patur për secilin vit?

2. A ka kërkuar AIF nga subjektet e detyruara për zbatimin e masave kundër pastrimit të produkteve të veprës penale të japin të gjitha të dhënat lidhur me transaksionet e bëra nga personat e dyshuar dhe të dërgojnë menjëherë këto të dhëna pranë SPAK gjatë viteve 2020-2026 sipas parashikimit të nenit 30 pika

</td>
<td>17.07.2026</td>
<td>

1. *A ka informuar AIF pranë SPAK për mjete financiare, të ardhura ose pasuri gjatë viteve 2020-2026 sipas parashikimit të nenit 30 pika 1. a) e ligjit 95/2016? Nëse po, sa raste ka patur për secilin vit?*

Një nga funksionet më të rëndësishme të AIF është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e informacionit mbi rastet e dyshimta tek organet kompetente, në DPPSH, Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm si dhe SPAK.

Përgjatë viteve 2020- 2026 rastet e dërguara në SPAK paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Tabela 1

<table>
<tr><td>Viti</td><td>2020</td><td>2021</td><td>2022</td><td>2023</td><td>2024</td><td>2025</td><td>6 mujori -2026</td></tr>
<tr><td>SPAK</td><td>14</td><td>29</td><td>10</td><td>26</td><td>36</td><td>32</td><td>18</td></tr>
</table>

2. *A ka kërkuar AIF nga subjektet e detyruara për zbatimin e masave kundër pastrimit të produkteve të veprës penale të japin të gjitha të dhënat lidhur me transaksionet e bëra nga personat e dyshuar dhe të dërgojnë menjëherë këto të*

</td>
<td>Përfunduar/ dërguar përgjigje me shkresë</td>
<td>Jo</td>
</tr>
</table>

		1. b) e ligjit 95/2016? Nëse po, sa raste ka patur për secilin vit? *3. A ka kërkuar SPAK pranë AIF të dhëna mbi transaksionet e personave të dyshuar për pastrim të produkteve të veprës penale gjatë viteve 2020-2026 sipas parashikimit të nenit 30 pika 2 të ligjit 95/2016? Nëse po, sa raste ka patur për secilin vit?* *4. Sa konfiskime janë raportuar pranë SPAK nga ana e inspektorëve shtetëror të autorizuar sipas parashikimt të ë nenit 30 pika 3 të ligjit 95/2016 për secilin vit 2020 - 2026?* *5. Sa sekuestrime janë raportuar pranë SPAK nga ana e inspektorëve shtetëror të autorizuar sipas parashikimt të ë nenit 30 pika 3 të ligjit 95/2016 për secilin vit 2020 - 2026?*		*dhëna pranë SPAK gjatë viteve 2020-2026 sipas parashikimit të nenit 30 pika 1. b) e ligjit 95/2016? Nëse po, sa raste ka patur për secilin vit?* Agjencia e Inteligjencës Financiare, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, u kërkon subjekteve të ligjit informacion dhe dokumentacion lidhur me transaksione dhe persona që janë objekt i procesit të analizës financiare apo dhe në kuadër të kërkesave të përcjella nga SPAK. Pas administrimit dhe analizimit të informacionit të siguruar, në rastet kur krijohen dyshime të bazuara për pastrim të produkteve të veprës penale, financim të terrorizmit ose vepra të tjera penale të lidhura, AIF përcjell informacionin e analizuar dhe konkluzionet përkatëse, të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës apo kthim pergjigje nëse ka qenë kërkesë. Lidhur me rastet e ndara në SPAK (të iniciuara nga AIF apo si përgjigje të kërkesave për informacion nga SPAK) lutem referojuni tabelave 1 dhe 2. *3. A ka kërkuar SPAK pranë AIF të dhëna mbi transaksionet e personave të dyshuar për pastrim të produkteve të veprës penale gjatë viteve 2020-2026 sipas parashikimit të nenit 30 pika 2 të ligjit 95/2016? Nëse po, sa raste ka patur për secilin vit?* Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, AIF shkëmben informacion dhe ka korrespondencë të vazhdueshme për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprave penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale apo financimit të terrorizmit me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, përfshirë dhe SPAK. Në këtë kuadër gjatë viteve 2020 – 2026 janë trajtuar kërkesa të shumta për informacion nga SPAK, të dhënat gjenden në tabelën si më poshtë: **Tabela 2** Viti: 2020 / 2021 / 2022 / 2023 / 2024 / 2025 / 6 mujori - 2026 Kerkesa nga SPAK: 14 / 189 / 81 / 103 / 139 / 55 / 61		

4. *Sa konfiskime janë raportuar pranë SPAK nga ana e inspektorëve shtetëror të autorizuar sipas parashikimt të ë nenit 30 pika 3 të ligjit 95/2016 për secilin vit 2020 -2026?*
5. *Sa sekuestrime janë raportuar pranë SPAK nga ana e inspektorëve shtetëror të autorizuar sipas parashikimt të ë nenit 30 pika 3 të ligjit 95/2016 për secilin vit 2020 -2026?*

Përgjigja per te dy pikat 4 & 5.

Sipas ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", neni 22/1, paragrafi i parë: "*Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale*.".

Informacionet e dërguara nga AIF me iniciativën e saj apo në përgjigje të kërkesave të SPAK-ut janë për përdorim në nivel inteligjence. Gjithashtu, AIF-ja nuk ka kompetenca të policisë gjyqësore. Për këtë arsye, punonjësit e AIF nuk kanë atributet ligjore për të kryer sekuestrimin e përkohshëm të objekteve, instrumenteve ose pasurive të dyshuara.

Nga ana tjetër, referuar nenit 22, pika "g", të ligjit të sipërcituar, AIF: "*Urdhëron, kur ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për pastrim parash, financim të terrorizmit apo financim të armëve të dëmtimit në masë, bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar për një periudhë jo më shumë se 72 orë. Brenda këtij afati, në qoftë se vëren elemente të veprës penale, autoriteti përgjegjës dërgon informacion në prokurori, duke dorëzuar edhe një kopje të urdhrit pezullimin e përkohshëm të transaksionit, ose për ngrirjen e llogarisë, sipas kësaj dispozite, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës. Pas kalimit të afatit 72-orësh nga nxjerrja e urdhrit, në mungesë të një vendimi për sekuestrim ose të një mase tjetër kufizuese të vendosur nga prokuroria ose gjykata kompetente, urdhri pushon së prodhuari efekte juridike*.".

Më poshtë paraqiten të dhënat për urdhrat të bllokimit të nxjerra nga AIF për vitet 2020 – 2026, si dhe ato të dërguara në SPAK:

Tabela 3

Viti	Nr. total i urdhrave te bllokimit	Pasuria totale e	Nr. i urdhrave te bllokimit për SPAK	Pasuria e bllokuar për rastet e dërguara në SPAK (Euro)

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td></td><td></td><td>bllokuar ne Euro[2]</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>2020</td><td>7</td><td>1,172,291</td><td>0</td><td>-</td></tr>
<tr><td>2021</td><td>3</td><td>250,240</td><td>0</td><td>-</td></tr>
<tr><td>2022</td><td>3</td><td>2,426,882</td><td>1</td><td>2,251,948</td></tr>
<tr><td>2023</td><td>4</td><td>1,178,350</td><td>3</td><td>1,138,720</td></tr>
<tr><td>2024</td><td>11</td><td>10,751,684</td><td>2</td><td>194,389</td></tr>
<tr><td>2025</td><td>8</td><td>793,375</td><td>3</td><td>180,000</td></tr>
<tr><td>6-mujori 2026</td><td>3</td><td>4,444,410</td><td>2</td><td>1,031,800</td></tr>
</table>
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>12.</td>
<td>08.07.2026</td>
<td>Kërkesë me email-gazetar

1. Datën dhe numrin e urdhrit/shkresës me të cilën AIF ka vendosur bllokimin/ngrirjen e përkohshme të fondeve, transaksioneve ose llogarive të x?
2. Shumën e bllokuar/ngrirë përkohësisht dhe monedhën përkatëse.
3. Bazën ligjore konkrete mbi të cilën është nxjerrë urdhri i bllokimit/ngrirjes.
4. Nëse AIF ka vepruar kryesisht, mbi analizën e vet financiare, apo pas raportimit/sinjalizimit nga një subjekt tjetër i ligjit nr. 9917/2008. Në rast raportimi, kërkojmë vetëm kategorinë e subjektit raportues, pa cenuar identitetin e tij.
5. Datën kur informacioni dhe dokumentacioni i këtij rasti i është përcjellë Prokurorisë së Posaçme ose organit tjetër të prokurorisë.</td>
<td>14.07.2026</td>
<td>Në funksion të shqyrtimit të kërkesës suaj, me anë të së cilës kërkoni informacion për individë konkret, vlerësojmë të nevojshme të evidentojmë disa nga parashikimet përkatëse të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

• bazuar në nenin 22, “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”, AIF shkëmben informacion me prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështje që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtarinë kriminale që gjeneron produkte të veprës penale, si dhe financimin e terrorizmit;
• bazuar në nenin 21, “Organizimi i autoritetit përgjegjës”, pika 1/1, “Përdorimi i të dhënave”, parashikohet se: “Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së personelit apo sistemeve në përdorim, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional. Agjencia e Inteligjencës Financiare duhet të arsyetojë kufizimin rast pas rasti.”;
• në nenin 22/1, “Përdorimi i të dhënave”, përcaktohet se: “Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror (...)”.
Më tej, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, ndër të tjera, parashikohet se:</td>
<td>Përfunduar/ dërguar përgjigje me email</td>
<td>Jo</td>
</tr>
</table>

[2] Perfshire Prokurorite dhe SPAK

		6. Kopje të urdhrit të bllokimit/ngrirjes së përkohshme dhe shkresës së përcjelljes në Prokurori, edhe nëse dokumentet jepen të anonimizuara ose pjesërisht të redaktuara.		• sipas nenit 2, pika 16, "Nevojë për njohje" është nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar gjatë ushtrimit të një funksioni të caktuar, me qëllim përmbushjen e një detyre zyrtare; • sipas nenit 3, ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, për të cilët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe bazuar në parimin "nevojë për njohje", kërkohet qasje në informacion të klasifikuar; • sipas nenit 19, pika 1, shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar kryhet me qëllim ushtrimin e një detyre, në bazë të parimit "nevojë për njohje", me miratim të titullarit të institucionit përkatës dhe vetëm nga persona të certifikuar përshtatshmërisht. Gjithashtu, sipas parashikimeve të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, neni 17, pika 2, e drejta e informimit kufizohet edhe në rastet që lidhen me sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar, si dhe në rastet që lidhen me parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë parashikimet ligjore të sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa juaj nuk përmbush kriteret ligjore për njohjen me një informacion të tillë. Në veçanti, nuk rezulton që Ju, si kërkues, të jeni organ i përcaktuar nga ligji për shkëmbimin e këtij informacioni, të provoni interesin përkatës ligjor në kuptim të fushës së përgjegjësisë, të përmbushni parimin "nevojë për njohje", apo të keni certifikatën përkatëse të sigurisë për akses në informacion të klasifikuar. Për sa më sipër, kërkesa juaj nuk mund të përmbushet, pasi nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore të zbatueshme.		